



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 1668 Prot

Tiranë, 31 /03 /2020

URDHËR

Nr. 213 Datë 31 /03 /2020

“PËR
MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E INFEKTIMIT NGA COVID-2019 TË
APLIKUESVE PËR NDIHMË EKONOMIKE”

Mbështetur në nenin 116, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe Ligjin nr. 10107 datë 30.03.2009, i ndryshuar “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 7 të ligjit nr. 57/2019 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të datës 08.03.2020 të Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri” si edhe të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”,

URDHËROJ:

1. Përrjashtimisht, gjatë situatës së fatkeqësisë natyrore, aplikimet për ndihmë ekonomike sipas Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, do të pranohen nga administratorët shoqërorë të njësive administrative në formë elektronike ose përmes shërbimit postar.
2. Deklarimet tre mujore të përfituesve të ndihmës ekonomike do të kryhen pas përfundimit të situatës së fatkeqësisë natyrore të shpallur për shkak të COVID-2019.
3. Për familjet/individët që sipas legjislacionit në fuqi do të kryhej verifikimi i situatës social-ekonomike përmes vizitës në familje nga administratorët shoqëror të njësive administrative, nën juridiksionin e së cilës janë banorë, verifikimet do të kryhen pas përfundimit të situatës së fatkeqësisë natyrore të shpallur për shkak të COVID-2019.

4. Listat e aplikuesve dhe përfituesve të ndihmës ekonomike dhe të fondit 6% të Bashkive do të regjistrohen dhe konfirmohen në formë elektronike ose përmes Sistemit të Menaxhimit të Informacionit nga Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, për sa i përket regjistrimit si punëkërkues të papunë.
5. Administratorët shoqërorë të njësive administrative mbajnë kontakte në formë elektronike/telefonike me aplikuesit, për t'u ardhur në ndihmë mbi mënyrën e plotësimit të të aplikimit për përfitim të ndihmës ekonomike.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Shërbimi Social Shtetëror dhe Bashkitë, si edhe për të bashkërenduar punën me Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

OGERTA MANASTIRLIU

